



rrëfim

**Gur**

Nga Elinda Marku

Ese

**NJË SHEMBULL**

**LIGJËRIMI POETIK**

Nga POZAIET QOSE



**EKSKLUZIVE**

**POEZI NGA**

Pavol Janik

President i Shoqatës

së Shkrimtarëve

Slovakë



**ÇMIMI**

**50**

**Lekë**

# 94 BELISK

REVISTË E PËRJAUSHME LETRARO-ARTISTIKE VITI I 3-të I BOTIMIT Nr.94 Prill2010

**Poezi**

**Elind Marku**

**Mëhill Velaj**

**Eleonora Gjoka**

**Ferdinant Laholli**

**Eljona Lupe**

**SAGA**

**E MAHNITSHME**

**E AMOS OZ-it**

Nga Dr. Moikom ZEQO



**TREGIM**

**PARAJSA**

**KISHTE NGJYRE**

**LEJLA...**

Nga Elda Çoku(Kallupi)

**Të faleminderit, Faik Bruçi!**

Nga Faik Xhani

**TREGIM**

**Dikatatori dhe**

**vizitori i bardhë**

Nga Stefano Benni

**Studim**

**Përse lexojmë prozë**

**letrare?**

Nga PATRICIA COHEN



**Ese**

**Letërsia dhe Globalizmi**

Nga Prof. Sadik Bejko

## Botues

Roland LUSHI  
cel:068 22 19 016  
cel:069 32 05 343  
rlushi@yahoo.it

## Drejtoare

Fatime KULLI  
cel: 069 22 03 991  
fatimekulli@yahoo.it

## Redaktor Përgjegjës

Dukagjin Hata  
cel: 068 30 56 014

## Këshilli botues:

Dr. Moikom ZEQO  
Fasli HALITI  
Shpendi TOPOLLAJ  
Iliriana SULKUQI  
Kolec TRABOINI  
Milianov KALLUPI

## Adresa e redaksisë

Rruga: Mine Peza,  
Pall. Kolombo2, Tiranë

Nr. llog. Pro Credit Bank  
12-106640-00-01

Nr. llog. Tirana Bank  
0145-308758-100

Shtypet në shtypshkronjën e  
Shtëpisë Botuese "ADA"

Tiranë  
Tirazhi : 500 copë

## Studim

# Përse lexojmë prozë letrare?

Nga PATRICIA COHEN

Për të ilustruar se sa studiues letrarë i marrin parasysh të rejtat e fundit lidhur me letërsinë, Liza Zunshine, një profesoreshë e anglishtes në Universitetin Kentucky, i referohet një episodi të serialit të mirënjohur "Friends" (shokët). Fibi dhe Reiqell bëjnë një komplot duke vënë në lojë Monikën dhe Chandler, pasi marrin vesh se ata po ruajnë një sekret. Çifti zhulon mungun dhe përploqet të shmanget, por Fibi e kupton këtë. Ja si i thotë Fibi Reiqellit "Ata nuk e dinë që ne e dimë që ata e dinë". Ky proces i gjetjes së asaj që mendon tjetri - e leximit të mendjes - është edhe një mjet letrar i thjeshtë, edhe një aftësi thelbësore mbijetese. Përse qaniet njerëzore janë të pajisura me këtë aftësi dhe cilat funksione të turrit e bëjnë të mundur këtë, këto janë pyetjet me të cilat po merren psikologët sot. Në ditët tona, profesorët e gjuhës angleze dhe studentët e diplomuar bëjnë të njëjtën pyetje, gjithashtu. Ata thonë se janë të bindur se shkencë jo vetëm ofron depërtime të papritura në tekstet individuale, por kjo mund të ndihmojë për t'iu përgjigjur pyetjeve themelore për ekzistencën e letërsisë: Përse lexojmë prozë letrare? Përse kujdesemi me kaq pasion për personazhet joekzistente të librave? Çfarë procesesh mendore aktivizohen kur lexojmë? Zunshine, specialiteti i së cilës është letërsia angleze e shkollit 18, u njoh me punën e psikologëve evolucionarë, ndërkohë që ishte një studente e diplomuar në Stanford në vitet 1990. "Mendoja se kjo ishte gjëja më ngacuese që kisha mësuar ndonjëherë", thotë ajo. Jonathan Gottschall, i cili ka shkruar gjerësisht për teorinë e evolucionit për të shpjeguar prozën letrare, është shprehur "është një moment shprese" në një epokë kur çdokush flet për "vdekjen e shkencave humane". Për z. Gottschall një avitje shkencore mund të shpëtojë departamentet letrare nga pafuqia që i ka rënë këto kohë. Entuziazmi për teorinë politike dhe të enëta deri në tani që aktivizon departamentet që nga viti 1970, 1980 dhe në 1990 - marksizmi, strukturalizmi, psikanaliza - tashmë është zvetënuar. Letërsia, ashtu si fushat e tjera duke përfshirë këtu edhe historinë dhe shkencat politike, e ka filluesën tek imazhi turor dhe parimet e evolucionit për të siguruar dëshminë empirike për teorinë e paprovuar deri në tani. Interesi ka qenë në kulmin e vet gjatë dekadës së fundit. Elaine Scarry, një profesoreshë e gjuhës angleze në Harvard, deri në tani ka organizuar shumë seminare mbi teorinë konjitive dhe artet.

# NJË SHEMBULL LIGJËRIMI POETIK

-Ese për poezinë

"Anës lumenjve" të poetit Fan Noli-

Nga POZAET QOSE

## 1.Mirëkuptimi i fjalës me realitetin.

Rrallëkujt mund t'i shkonte ndër mend që t'i vinte poezisë me këtë lëndë titullin që ajo mori prej autorit të saj e që e mban dhe sot e kësaj dite, "Anës lumenjve". Shurëkush në të tilla rrethana do të rëndte ta titullonte " Fat i hidhur", " Arrati e pasosur", "Arrati dhe shpresë" a diçka tjetër të ngjashme me çfarë thanë në sipër , duke menduar se ata do t'i shkonin për shtat asaj që po shkruanin për lexuesit e shumë vjetëve më pas. Mbase intuita e poetit, mbase logjika e stilistit, mbase të dyja bashkë sendërtuan këtë kryethënie për poezinë, që do të mernte trajtën e një himni të trishtuar , të zhgënjyer e të zhveshur nga çdo lloj misteri për shqiptarët. Vetëm shurësi i emrit " lurë", i paraprirë nga një parafjalë e rasës rrjedhore mund të shprehte në mirë se çb gjë tjetër realitetin personal të një ikjeje të dhanëshme e të përmalltë, e cila endej nëpër lotë me kokën kthyer pas nga pika e nisjes së asaj, që do të ishte dhe do të mbetej mrekullia dhe mizoria e vetme për poetin. Një rrjedhje e pasosur idhëtie, jo një zgjedhje e vullnetshme, por një detyrim i dhunshëm krijon një realitet të ashpër e tronditës.

Një strofë dhe aq është mrefimi për veten. Katër vargje, të barabarta me një portretizim të skajshëm të njeriut të mbetur pa atdhe. Gjeografia e portretit lëviz me një shpejtësi marramendëse përgjatë lumenjve të huaj, ku më shumë se kudo tjetër ndihet largësia me vendin e braktisur dhe pesha e fakteve që, prodhuan portretin e shfytzuar të një njeriu, që nuk e do kombin e vet me pallavra, por me vepra konkrete. E nëtejshmija i lihet në dispozicion vendit që e desh dhe njëkohësisht e zoi poetin në një çast drejtpeshimi të hurbur . Kundërshtitë pas një pyetjeje, që është pranë mënyrës se si komunikohen thjeshtësisht brengat e mëdha (

"..Kë e lamë e kuna mbeti...") krijojnë njëra pas tjetrës me qetësi, siguri, duf, kurajë qytetare e përgjegjësi njerëzore tablonë e njerë të Shqipërisë së kohës. Një shkretim thujse universal ( si në momentin biblik të Noes) sjell përfytyrimin e një ekzistencializmi absurd. Të jesh i palarë pranë detit, i pangrënë pranë sofrës, i panxënë pranë dritës. Ka torturë e trerë më të madh se kaq, ka panje më të pakuptimtë se kjo?!

Brenda kësaj panjeje gjëllojnë numërueshëm ata që e kanë pikturuar një absurditet të këtyre pëmasave; derbederët, mercenarët, bejlerët, jabankhinjtë, fajdexhinjtë.. Nuk e besoj se Noli e njihte shqipen aq pak, saçë të mos gjente të tjera fjalë për këta pikturë të së keqes.Ai vullnetshëm zgjochi fjalë të gjuhës turke, për t'i lënë jashtë pëmasave reale të kohës dhe jashtë hapësirës nga ai dëshironte të ecte Shqipëria.



Prenë, vranë, shkretuan.. Fjala shpreh saktësisht dranën dhe tragjedinë e një populli, të lënë në mëshirën e fatit. Dhe pak në poshtë tjetër panje e poetit, që krijohet aq besnikërisht prej fjalës. Për më tepër se pjesa tjetër e portretit të tij, është pjesa tjetër e tablosë, që në rrafshin filozofik të kohës s'ka vetëm të tasme, por dhe të ardhme.

Janë një varg foljesh të një tjetër regjistri ato që ndërtojnë këtë realitet të ri poetik; vëngon, luçet, zgjon, gatitet, pëlçet, kërcet , fryhet, dardhet, skuçet. Ëndritet, ndriti, gjëron, ngrehuni, etj. Dhe, pas kësaj, ligjërimi kthëhet përsëri në startin e qetë nga u nis, por tashmë me një koncept të ri; me atë të përcjelljes së një tabloje, që përputhet tërësisht me detyrën e poetit përballë popullit të tij e gjithë njerëzimit. E







njëjta stilistikë vijon deri në fund me një brohorimë të gëzueshme, edhe pse atje larg, ku nisi mëfimi i dëshpëruar i zymtësisë kohore dhe hapsinore.

Vetëm stilisti i përsave të Nolit mund t'ia dalë mbanë aq mirë përdorimit ekonomik të fjalës, për ta përshtatur atë me përfytyrimin që krijon, si një film, kuadrat e të cilit zëvendësojnë njëri-tjetrin, duke krijuar modele të pashlyesme në turin e shikuesit. Për stilistin gjuha është e shenjtë dhe ajo nuk mund të shpërdorohet e aq më shumë të përdhohet me cinizëm e pakujdesi. Një fjala shqipe e kësaj poezie është në mirëkuptim të pashanbullt me realitetin që krijon, emocional apo ideor qoftë ky.

Nuk më intereson shumë fakti nëse janë apo jo të sakta dhe të pranueshme gjykimet e Nolit, përfundimet, thirrjet e grishjet e tij. Më intereson vetëm ajo ngjizja e natyrsme e fjalës me thelbin kuptimor të ligjërit poetik. Gjithçka inkuadrohet brenda një estetike realiste, prej së cilës lind materia poetike dhe trokasin ide brenda kufijve të normales, pa asnjë lloj nuance deformimi dhe boshllëku.

Ku ka shërbim më të madh se kaq për poezinë në veçanti dhe artin e fjalës në përgjithësi? Fjala dhe mendimi këtu bashkëjetojnë në harmoni dhe na mësojnë shurë për artin e të shkruarit.

## 2. Begatia stilistike e poezisë.

Kur njeriu dhe poeti takojnë njëri-tjetrin dhe i japin bujarisht sho-shoqit më të mirën e vetes, poezia fiton një mezatim verbas e jetëgjatë, sepse trupit të hijshëm të fjalës së saj i vishet rroba e magjishme e figurës. Me këtë përkushtim e shkruan Noli këtë tekst poetik. Një shkallëzim i krijuar nëpërmjet epitetëve çel poezinë. Brenda tyre tingulli "s" përdoret me një denduri të pasqorë, sikur kërkon të krijojë një gjendje ankthi e pasigurie ( arratisur, s'gjynosur, maskapitur, katosur, pa shpresë.. etj). Një fonostilistikë kërcënuese dhe aspak miqësorë, njëkohësisht. Fjalët pyetëse që ndërtojnë pyetjen retorike në fillim të strofës së dytë ( Ku e larë e ku na mbeti..), , të pasuar nga një vajtim aliteracionor, të " vjedhur" nga poezia popullore ( Vaj vatani e njerë milet), ngjajnë më tepër me një pashtrimë ngjethëse, me këngën e qyqes. Më poshtë një sistem i tërë antitezash, i krijuar jo nga kundërvënia e drejtpërdrejtë kuptimore e fjalëve, por nga pranëvënia e dukurive të kundërta, deri në ekstrem ( ... anës dritës i paparë, etj) janë shprehje e figurshme e një pamjeje të përshkruar me aq

draracitet e dhenbje njeriu. Shkallëzimi ngjithës i strofës tjetër është një procedim i shkëlqyer stilistik, kreshndbja e të cilit është dëshpërim njerëzor e poetik, që fare kursyeshëm jepet me foljen "shkretuan" dhe ndajfoljen " anëmbanë". Po le të ndalem te përfitesat stilistike që autori realizon nëpërmjet përdorimit morfologjik të emrave të lumenjve. Metonomia e tyre është fare e qartë. Elbë, Shpresë, Rin, Turë, Vjosë, Bunë, etj. e kanë humbur vlerën e drejtpërdrejtë të toponimeve dhe kanë fituar një kuptim të ri të figurshëm, për të cilin, kushdo që e njeh sado pak Nolin dhe rrethanat e krijimit të kësaj poezie, ndihet krejtësisht i këthjellët në interpretimin e tyre. Kjo përmasë e re është ekzistenca e njëkohëshe brenda dhe jashtë etnitetit tënd, një dualitet shkatërmues deri në torturë. Përsëri një strofë me shkallëzim ngjithës ( çirren, digjem.. sakatosur, çamatosur/ as i gjallë, as i varrosur..), përsëri fonostilistika e tingullit "s", si bërthama organizuese e një deliri të përligjur, që lind nje Hamlet shqiptar. Tjetër shkallëzim vijon në strofën, ku Noli kushton. Marrin pjesë në të të gjitha zanoret e shqipes, duke krijuar një simfonitë të vërtetë tingujsh, që pëmbysin pjesën tjetër të tekstit, pa asnjë lloj mëdyshjeje ( vëngon, huqet, gjumi, zgjon, gatitet, fryhet, skuqet, ndriti, jeta, trompeta..).

Brenda këtij shkallëzimi gjëllon dhe metafora, si një përpjekje stilistike për ta shtuar tonalitetin dhe forcën e fjalës e të vargut. Më poshtë simboli ( verë), që i kundërvihet simbolit tjetër ( dinër), duket sikur qetëson çdo gjë, duke u bërë struktullar i shpresës e qetësisë.

Dy vargjet hyrëse të strofës së parë e të fundit projektohen me të njëjtën strukturë stilistike, por ato që i pasojnë dhe përbëjnë epilogun i poezisë janë një thirrje e fuqishme artistike, edhe pse kanë të përdorur dendurisht si në vargjet paraardhëse tingullin "s", që thyhet mequllisht nga tingulli "b", për të krijuar një pamje të re brenda e jashtë poetit ( brohoras, besë..)

Ç'ë bën tjetër muzikal këtë tekst poetik? S'do mend përdorimi i shpeshtë i anaforave( anës detit, anës dritës, pranë sofrës, pranë dijes, seç e shtypën, seç e shtrydhën..etj.)

Të gjeshe kaq shurë figura stilistike në një poezi të vetme, është një dëshmi dmetshëse. Komenti i saj është i thjeshtë: Vetëm përgjegjësia e lartë artistike mund të sjellë një begati të tillë.

Noli shfrytëzon të gjithë fondin aktiv të gjuhës, për të realizuar përfitesat stilistike. Kjo veshje e figurshme i përshtatet logjikës së brendshme të tekstit dhe na kujton se një tekst i vlefshëm, i formatuar në vargje, nuk mund të quhet i bukur, po të ndahet nga paraqitja e tij artistike.

# POEZI

Ferdinand Laholli

Büksenburg, Gjermani

## është viti

Shqyerje sysh  
që nuk shohin asgjëkund  
Përplasje buzësh  
që s' thonë asgjë  
Është viti , kur Krishti  
u ringjall me ne fund  
në kërkohet që njeriu  
po vdes edhe më.

## bashkudhëtar

Njdhja e të tjerëve nis nga njdhja e vetes  
thra i urti dhe vdiq nga fjala e thëne.

Desha t'i njihja të gjithë rreth meje  
u nisa vrullshëm në rrugën drejt vetes.

Gjykuan se më duhej edhe një shok për udhë  
e më dhënë...  
panundësinë për dore.

## loja e jetës

U sosën edhe ato që s'kanë qenë kurrë  
pastaj mbeti hiçi.

Merreni- thanë  
është falas  
churatë.

Dhe u sulën të mençurit e qmendur  
dhe u sulën të qmendurit e mençur .

në mirë me hiç  
se pa asgjë.

## në mes të ditës.

ndëza një qiri  
për të parë veten  
t'i flisja  
e ajo të më besonte  
që jam unë.



Nga

Elinda Marku

## Tigri i Borgesit

Kam kohë që lodhem të zbus  
Tigrin e Borgesit.  
Nuk e di e kam , apo zbutur me ka?!.  
E shoh si përballë meje min, ulur  
Në bisht , në trung të një peme  
Të vjetër , sa molla e ndaluare.  
Tigri i Borgesit e ka origjinen në Eden  
Atje tek molla e tek fillimi.  
Nërsa jam zatet, as e zbutur as e mundur ,  
Në penën buzë rrugës së madhe  
Nga gjithëkush kalon.  
Në mos e gjuan me gurë,  
Ia këput një degë ,  
Të trembë mizat,  
a të bëj fresk!  
Të dy mirë përballë:  
Unë këndej,  
Tigri i Borgesit atdij.  
Vet Borgesi ...  
Bastunin e ka kthyer në fyell  
E po i bie!  
Çoban që na nuan të dyve,  
Mia me nuan prej tigrin,  
E tigrin e nuan prej zbutjes!

# Gur

- Nga Elinda Marku

Ky gur ndoshta asht ditari im i pashkure. Asht dëshnite emija te pakallzuar e te pakallzueshme. Ky gur ndoshta asht atllasi i te tana mugeve qe kam shkel e ato qe do t'kisha dësht me i hap. Asht muri me te cilin mund te kisha rrethu tan peret e globit, prej dëshires me e kthj glboin ne kqesht si ai i Edenit qe, nuk e kemi pa, por na e marr mendja se sa i lukur dhjet te kete qene, se sa i lukur asht. Asht gur, me te cilin do te kisha ngrit qytete... qe t'i ngjanin fshatit tim. Asht Gur, te cilin do ta ktheja ne shtat te te gjithë ujtave...

E ne mos asht keshtu si me duket mu, ky Gur, ju siguroj se asht guri qe rnan te tana araretet qe nuk mujta me u qene dëshmitare, araretet qe nuk mujta me i kry. Asht Gur rmbi te cilin edhe une kam shtu araretin tim, te padëshirfrueshem. Ky Gur asht bash krejt si rafaka ime, ne mos qofte vete rafaka!

Nje nadjë, prej atyre nadjëve, qe nuk kane dale ende ne vere. Pranvera pra, kur lumi ishte ende ne pritje te "rotave" te vegjel te fshatit. Ato nadjë e ato pranvera kur moshen e kisha te famijes, por famijet me dukeshin shure te mitur me ndej me to. Te miturit, shure te djallezume. Iodrat shure te munguara. I bija rreth doonrit ne mundja pak para se t'i videsha atyre qe nuk ishin ne doonr por brenda n' shpi. T'i videsha edhe doonrit vete e te rrojta teposhte e ne lumin buze fshatit. Fshati buze lumit. Jo shpia "ime" buze tij. Buze lumit kish ngrit kullen Ndue Bardhoku, si duket i vetmi qe nuk i trarbej ujit. I vetmi qe nuk e vriste mendjen se uji mund te mernte dran rreshqanthe per t'u ba na i gjare se ishte kur ai e ngriti kullen.

Zinjja vend ne nje kthesë qe uji e kish ba vete, si per te me fshetur prej gjithëkujt qe qellonte me arch ra ne zalle, gjoja me la teshë, gjoja me zan peshk, gjoja me u taku me dikend, gjoja me mbledh dushk, gjoja me mbush gorarin me rane...! Mue, atehere cob gja qe banin te miturit, ne dukej se i banin per gjoja, per medemek.

Nje nadjë rash ne lum. Qeshe idnu... Kam qene

fimije idnak. Ika prej shpise e nuk u ktheva vec rbasë kishite marre dielli. Nuk u fsheta ke kthesa qe kish ba uji i lumit. I rash tan liri zallit e lumit ate dite. U lava e u thava me gjithë teshë vesh, dy tri here. Lujta me ujin e mblocha dy tre grumbuj me guralece zalli. Gjeta nje gur a guri me gjeti mu. Nje gur te madh sa kater grushta te dy famijëve te bare grusht. E mora gurin. I gjeta syte, ose ia vuna. I gjeta vetullat ose ia vuna edhe ato. Hunden, gojen, mjekrenen. Vec veshet nuk ia gjeta, as nuk ia vuna. Kur mori dielli, une mora gurin e ktheva fundin e fustanit dhe e fsheta. Ruges per ne shpi me pane mjaft te mitur nga ato te djallzumit, por qe padjallzisht me pershendeten e nuk me pyeten se ku kisha qene as se cfare fshihja ne fustan.

Kur riberrita ne doonrin qe edhe ai dukej se kish ndej vetem tan ditën, rbasë e gjeta si e lashe. Pak para se me hyj brenda ku me siguri njani prej te miturve qe kujdesej per mu, kishte gjete kche me dale deri ne fund te doonrit me pre nje thuper thane, me ribajte anes vetes, per me e perdor sa t'hyja mrene. Me e perdor njeheresh me pyetjen: Ku je gjerre (gjerre-hurb) tan ditën e lume?.

Ditën e lume! Asgja s' ishte e "lume" ne ate fshat as ne ate shpi, pervec lumit. Tuj e dite se c'ka me priste brenda, e morra gurin prej fustanit dhe e lashe ne parvezin e jashten te dritares, qe vinte pak para deres. Ajo dritare i binte te ishte dritarja e dromes se fjetjes, sicb qe askush nuk flinte brenda. Te tre flimin ne guzhine. Une flija me nanen Dile, ne nje munder -shtat, ne te majte te oxhakut, ndersa Lala ne munderin -shtatin tjetër, ne te djathte t'oxhakut. Ditën minin ne munder e raten flinin po ne munder. Rr, raten munderi ndenronte emrin, e behej shtat.

Te nesemen une e kisha hamu gurin dhe ditën e kaluare. Kerkoja nje vrime per ikjen time te re. Vecse tash nuk doja me shku ne lum. Doja me shku ke vorret. Me i kallzu ranes ose te pakten vorrit te saj se ka kisha ba nje dite na pare, se ka m'kish rbdhe. Kaloj pranvera ne vere, e vera ne gusht ra, po hic per gurin me u kujtu. Nje dite nga keto te gushtit rana Dile kish vjele dorate jeshile ne kqesht e po i thante me piru. T' thaurat i fuste ne nje voze druni te cilen e kish mbush deri ne gjysen me uje te tejdkushan e n'uje kish hech kripe te zeze e te trashë. Midis vetes e vozës kishte Gurin qe kisha pru une ate dite pranvera prej lumit e





lene ne parvazin e dritares. Kur pashe Gurin ndjeva nje deshire me ia vjedhe, e sigurte se nuk do te mundja. U ula dhe reja perballe saj deri kur ajo i ribarroj doratet se themi, deri kur i ribarroj e te tan te vdekurit e saj se qami. E kishte zakon sa here ulej me ba ndonje pune brenda ne shpi, si psh me ba corape me shtiza, me aru teshat, me qap teshat e reja te dokes, me lidh lutrat ose qapet etj etj, qante me fjale do njerex te cileve une ua kisha mesu emrat vetem prej vajeve te saj. Ma shpesh ema, qante nje Zef, tuj thane: "zefi i mire i imi, villai i imi i vetem" Kur qellonte me qap Zefin, me shkonin lotet edhe mu. Nuk e di kush mu dhimboste ma fort, a Zefi qe qante ajo, apo ajo vete, e cila mbytej ne lot e ne denesa per te. (tash qe jam tuj u afiu moshes se atehersme te nanes Dile, e kap vetem shpesh tuj qe gati gati krejt si ajo, me fjale. Ndonjehere krejt pa kuptu qaj edhe Zefin e saj qe kurre nuk e pashe as nuk e njofta, pervecse neper vaje")

... Ne fund, u ngrit vendosi Gurin ribi doratet ne krye t'vozes, shtyu vozen ne fund te dhores qe qanim guzhine. Mbi gryken e vozës mrinte Guri ribi doratet, hodhi ribi to nje cope nape. Llidhi nyje qoshet e napes dhe filloj me u marr me dicka tjeter.

Tan gustin qe teproji, tan shtatorin, tan tetorin e tan nardorin, mija mbrene, ribas saj, afer saj, perballe saj kur ulej me ba ndonje pune e me qap te vdekmit. Rrija mreth e motull saj e vozës qe ribante Gurin. Gurin tim!

Ma ne fund, aty nga fundi i Dhjetorit "nuaj i madh i vjetit" e qante ajo, diku prej se ishte e ndalime me i pemend kshnellat), u ribaruan doratet. Lau vozen, nxorri Gurin dhe e vendosi bash ke dritarja ku e kisha vu une ate dite kur e solla prej lumit. Me t'u fut ajo brenda, rreca une jashte. Mora Gurin tim, e futa poshte xhaketes se Lales te cilen e vishja neper shpi dimrit. Hyna me gjithë Gur ke dhoma e fjetes ku askusht s'flinte. Aty pervec do "mbilje" te vjetra, fort te vjetra, kishim edhe nje dollap mrdash. Edhe ky i vjeter, ose ma i vjetri. Ishte me gjase nje dollap mrdash qe kish gjithedcka brenda pervec rreca jo, qe e kishin lane italianet e ribetur pa u kthye, kur u kthyen. E nuanin si kujtim a si pasuri? Kurre nuk e mora vesh. Sa here shkonte nana Dile me kerku ndonje send ne dollapin e mrdave pa rreca brenda, fliste italisht, ku ta dish se me ke. Mu deri vone me dukej se kjo plake e arrendur flet edhe me sendet, edhe me kafshet, edhe me te vdekurit, edhe me hijet, me... ku ta di un.

Kur ikja ne shkolle ndjeve, prej friket se po i dhet nanes Dile ndonje send nga sendet qe kishte ne dollap, e merrja Gurin tim fsheturazi dhe e futja ne canten e librave. Shpesh me duhej me lane ndonej liber ne shpi per me merr Gurin ne shkolle. Kur shkova ne shkolle te mesre, tash me kish ba Lala nje "dollap", ark me denasa per gjanat e mija personale. Moasi e birca Lalen tinzash Nanes Dile me m'i vu arkës time, nje dety vendosa me e lane Gurin ne shpi, ribreca ne arke. E ne vend te Gurit merrja ne shkolle "velsin" e arkës.

... Shkoja prap ne lum dhe ke vorret. Por nuk mija dot tan ditën. Nuk mija dot tan ditën se ne mos nuk do te me lecitnin per te arrendur do te me lecitnin per kurve. Po, me shku shkoja, gjithenje e ma rralle ne lum e gjithenje e ma shpesh ke vorret.

... U bana me u martu, e me u martu nuk ndigjoja. Ose nuk nigjoja, ose nuk me martonte kush. :) Keshtu m'u desh me e lan shpine, pleqte, fshatin. Shkova ne kryeqytet. Tuj e dite se kam per te perfundu me m'lecit ose per t'arrendun ose per kurve.

Normal, qysh ndryshe mund te lecitej nje femene 25 vjece qe e len shpine e fshatin, pervecse kur e len me shku ke burri?!. Ana Gurin tim e mora me vete. Sa here, atje ne kryeqytet me merrte malli me shku ne fshat e s'mundesha, merrsha Gurin e fusja ne shtizat. Dhe sa here nuk mundesha me e duru mallin per fshatin e pleqte, i lutesha ndonjanit per kolegeve te punes me ardh me mu e me u shtir sikur po vjen me m'feju. Boll me arrit me i mrej pleqte, me i kraq pleqte se edhe une tash po fejcham.

Kryeqyteti pune pa krye. Po bahej perdite e ma i huaj. Madje kishim fillu me i thirr nje erer t'huaj. Si bicim "metropoli". Te tana muget me u t'huaj prej atij vendi, gjithedeshin sidomos ne kryeqytet. Un me fat, si perhere. Me del me e gjete njanen prej mugeve qe te t'huaj, e ika. Ikama larg se mund t'me kish shku mendja. Mendja, e cila deri atehere bridhte tan coshet e botes, por pa mua. Nje dite me mori mendja me vete. Moasi u bare te dyja bashke u nisan nga syte karbet. Ne fakt ishim kater kur ikem. Ishim kater. Une e I dashuri im, mendja e Guri (im). Tash, atje- ketu ku jemi, jemi shumu!

Kishte dashte Zoti e shurdheshin edhe te ikurit!!!

# EKSKLUZIVE

POEZI NGA

Pavol Janik



Magjister, PhD, Pavol Janik, President i Shoqatës së Shkrimtarëve Sllovakë, fitues i shumë çmimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, poet, romancier, dramaturg.

## E ÇUTITËSHME

Unë zmadhoj ujët  
Ku ke reflektuar fytyra jote  
Dhe me një të bërtitur  
E ndaloj që të mos derdhet

Të drejtohem ty me frymë  
Pa asnjë fjalë, vetëm me frymë  
Përderisa ti je një qelq me akull  
para gllënkës.

Të dridhurat të pandalura nën syprinën e  
mpirjes tënde  
dhe në fund për një moment llaps  
ja pse po pres ditën  
kur do të jesh e tëra zjarr

## TEATRI I JETËS

Jeta s'është tjetër, veç shfaqje teatri  
një shfaqje që duam ta luajmë gjithmonë  
Kur jemi në qejf, kostum e kollare  
a s'i ndërrojmë me rrobat e kllounit?

Vrapon jeta, rend, nga lluca në pellg  
me ne sillat jeta si të jetë lavjenës  
këtë e di mirë, e ka provuar çb brez  
siç ka qënë s'bëhet më jeta asnjëherë

Një gotë e mbushur pëplot është jeta  
që derdhet nga pak, përditë, në çdo vënd;  
poshtë thembrave tona, çfar derdhet ndalon  
poshtë thembrave tona duam të kemi dikënd

Janë ama në perde ...janë ama dhe shpirti...  
Në fund të vjen vdekja - shahmat loja jote  
Po prap meriton të luhet kjo lojë  
Ji i gëzuar ..në fund të fundit , ti mrojte

Ka gjetur kjo jetë në skenë një pasqyrë -  
Ajo vjen e gjallë me të ditpërditë.  
Nëse ty diçka të tundon në teatër  
Lëviz drejt kohëve antike

Rri mirë, rregullohu në fronin tënd bosh  
Mësoji me zërr ti çastet e jetës  
Nëqftëse gogësin gjatë shfaqjes së saj  
Atëherë ..shiko, kthe parat e biletës

## NJU JORK

Në një pasqyrë të rrafshët  
Të gjirit të pispillosur  
Shënjat e një qyteti kockëdalë  
Që I ngul thikën qiellit të shëndritshëm

Në detin e shëndritëshëm të llampave  
Duke këkuar flirt lëvrijnë varkat  
Fërgëllojnë mahnitëshëm



Në këmbët e tua të shoqësuara  
duke lundruar në ultësirën e kuvertës  
së një brocade me veshjen e mbrëmjes

Papritur, të humbet tjetri  
Si gjilpëra në kashtë

Diçka kemi marrë me vetë-  
zgjatin lumuzinat  
lodrojnë ketrushët në "Central Park"  
dhe trupit i metaltë i lirisë së vdekur.

Në Nju Jork gjithçka të bëhet lësh  
Mbrëmjet e shëndritëshme llapsin.

Shkëlqen njëmijë armëshi i mega qytetit  
Shkruan mesazhi i Ajnshtajnit rreth  
shpejtësisë së dritës  
çdo mbrëmje nëpër llapsien e sipërfaqes së  
ujit.

Dhe sërish përpara muzgut  
pëmbushet ekrani i argjentë  
i qiellit të Nju Jorkut  
me hektolitrat e gjakut të Hollivudit

Deri ku arrin perandoria e xhamave dhe  
mermereve?  
Deri ku nishani i raketave të larta të  
grataçieleve?

Zoti blen një "hot dog"  
Poshtë një ruge gjashtëdhjetë katëshe

Zoti është një zezak  
Që dëshëron kolorin gri të konkretes

Dielli i tij ka lindur prej tij vetë  
në një kuti kartoni  
nga lloji më i ri i skllavit

## ENGJËLLI DALLOHET NGA PENDËT

( Për prindërit e mi, që kanë shkuar, që s'janë më )

Në thellësitat e intimiteteve të mia shfaqen  
skelete  
dhe e gjithë memoria ime e çelqët dridhet.

Në fund të heshtjes për të dëgjuar shiun e  
vitit që shkoi  
se si ai diktonte pëshpëritje  
– Telegrami i tij i pakuptueshem:  
Një grup engjëjsh të trishtuar  
po rënkojnë nën ndriçimin e e hënës.

Lumi - drejt theqafjes nga mër zia,  
shpirti që po vdes i ujit  
gremiset teposhtë  
për te shtrati i tij i qetë.

Ndjej mëshirë  
pas eksplozionit të gjakut  
–kanë hyrë nëpër venat e mia  
ëngjëjt supersonikë  
ardhur nga të vdekurit.

Motorrat e tyre shurdhonjës  
fillojnë që në turin tim.

Kur ata ngrihen  
nis qetësia më e thellë  
gjatë së cilës më bëhet se dëgjoj  
se si ata derdhin nëpër parket  
perlat e distancës

Shfaqja e mëngjesit me loë të ngrirë  
nguros në sytë e mi  
që ende kanë kaq vjeshtë.

Shqipëroi Riza Lahi

Në ditët e sotme leximi i vërtetë është kthyer në tepër në një mit. Ideja e (vdekjes së leximit) skajëzohet, përhapet si një mjegull. Nëse përjetojmë epokën e spektakleve, perandorinë e pakufishme të imazheve, duket sikur leximi vet jāk i librave është

jashtë kohës. Leximi është bërë i vështirë. Por kjo nuk vërteton zhdukjen e tij. Leximi është një proces i ndërlikuar dhe i jashtëzakonshëm i intelektit njerëzor, që përherë ka të ardhme. Në kaosin e pafund të tregut botëror të librave, librat e vërtetë mund të quhen libra soterikë, d.m.th. shpëtimtare. Të orientohesh në kaos, do të thotë të lexosh libra të vërtetë. Rrallë herë në jetën time prej lexuesi kureshtar dhe të habëzitur më ka qëlluar të njihem me një libër të tillë siç është romani "Rrëfim për Dashurinë dhe Ehrësirën" të shkrintarit Amos Oz.

E mirënjohura Nadime Gordimer ka thënë diçka proverbiale: "Amos Oz është zëri i çartë mes kaosit". Ky është një zë i artikuluar me shkronja, për t'u përkthyer në gjuhë të ndryshme po nëpërmjet shkronjave. Një hollësi: Fjalët e shkruara në hebraisht duken pak të çuditshme dhe komike, kanë vetëm bashkëtingëllore dhe jo zanore. Modernizimi i gjuhës së shkruar hebraishte, duke futur shkronja të veçanta për zanoret është një proces, ku zanoret (sipas shprehjes së babait të Amos Oz-it) "janë policia rugore e të lexuarit".

Amos Oz është një nga shkrintarët më të mëdhenj të kohës. Ai është kandidat për çmimin Nobel, jo vetëm për Letërsinë por dhe për Paqen. Diçka krejt e rrallë dhe e veçantë. Kjo për shkak të humanizmit të tij universal. Mundet të jesh hebre dhe njëkohësisht të jesh pjesëtar i të gjithë popujve.

# SAGA E MAHNITSHME E AMOS OZ-it

— Nga Dr. Moikom ZEÇO —

Kështu matrica etnike, në vend që të rbyllet në vetvete hapet, sepse për shkrintarin ka në të vërtetë një matricë, atë të njerëzimit në tërësi, ku dallimet etnike dhe gjuhësore sfumohen dhe humbin.

Amos Oz megjithatë e ka identitetin e tij të padshirë. Ai shkruan ato që di dhe kupton shumë gjëra, shumë thelbe që u përkasin dhe të tjerëve dhe botës në përgjithësi. Ai duket se është klasik, nuk kërkon të bëjë revolucione të shtërpta të formës. Ai është i thellë në analizat e tij, pamëtuar të krijojë botë onirike, apo të shtegtojë në perandoritë e tyta të metafizikës.

Amos Oz shkruan një roman, ashtu si dikur Shën Agustini shpalosi "Rrëfimet" e tij. Kështu u krijua një tipologji letrare e frytshme dhe përherë e lakmuar. Amos Oz, me një kulturë koncentrike, me një talent zbirues të pazakontë, shkruan historinë e familjes të të afërmeve të tij, të të njohurve duke ndërtuar një univers ekzotik, hebraik, njerëzor, konkret dhe shpirtëror.

Që ky roman është një sagë ose një ep, kjo nuk ka asnjë dyshim. Ka qenë e vështirë vendosja e një ekuilibri të artë në tërësinë e detajeve të rëndanta, befasishe dhe të paharueshme dot. Ndihet në roman institucioni i kujtesës vet jake që mbart koeficientët e kujtesave kolektive, të makrokozmve dhe mikrokozmve të njeriut në vetvete, si popull dhe si njerëzim. Ky është sekret i patjetërsueshëm i artit shkrintar të Amos Oz-it. Kur them

se ka krijuar një sagë ekzotike kam parasysh një botë referenciale. Kam parasysh, gjithashtu mjeshtërinë e pabesueshme të komunikimit.

Rrëfimi i tij është sa linear, aq kaleidoskopik. Vizionet e tij ripërtërijnë kujtimet, duke krijuar

vorzuj mozaikësh, ku fragmentet kanë një pushtet të plotë, plotësojnë njëri tjetrin deri në infinit.

Duhet thënë se Amos Oz beson si askush tjetër shkrintar sot në botë në tipologjinë e personazheve, kaq shpesh të anatuar dhe të përdurur nga estetë dhe shkrintarë të tjerë. Kjo tipologji e personazheve, në të vërtetë, është një kozmogoni e spiritit.

Kam lexuar shumë libra për hebrejtë dhe hebraizmin. Edhe vetë kam shkruar disa herë për figurat e mëdha kulturore, ose religjioze të hebrejve, për Kabaalën, për talmudizmin, për poetët dhe mendimtarët, filozofët.

E kam studiuar teologjinë negative dhe antinjerëzore të antisemitizmit, formulat apokaliptike, teoritë e komplotit, unrejtjen e përbindshme racore etj, etj. Kam shkruar për Sabatai Zevin, por edhe për Martin Buberin. Kam shkruar gjithashtu edhe për disa dëshmi të lashta të pranisë së hebrejve që në shekujt e parë të erës sonë në brigjet e Shqipërisë, si në krahinën e Vlorës, në Orikum, në Orhezmi, në Elbasan, në Durrës etj. Në këtë qytet të fundit e kam zbuluar një monument mbivarror që i takon një hebreu dhe që ka një mbishkrim të çuditshëm.

Natyrisht që të gjitha këto më çonin te një njohje asnjëherë përfundimtare. Më ndihmonin por nuk më sqaronin plotësisht. Më grishnin por nuk më jepnin një dije



përfundimtare.



Fakti që shqiptarët u shquan gjatë Luftës së Dytë Botërore si mbrojtës të hebrenjve të persekutuar, pra si kundërshtarë të Holokaustit, në ka krijuar ndjesinë e një miqësie dhe nderimi. Poezitë e poetit Jahuda Amikaj, (poet shumë i madh) në kanë bërë që ta ndjek prej vitesh emrin dhe librat edhe të Amos Oz-it.

Saga e Amos Oz-it i afron të gjithëve pa përjashtim një kujtesë të shkuarve. Persekutimi i hebrenjve është i lashtë, babilonik, egjiptian, në tërësi biblik. Historia e tyre e shtegtimeve është një histori e mallkuar për një kohë shumë të gjatë, frikërisht të gjatë. Kjo është arsyeja që Amos Oz shkruan "Isha një fëmijë i mrekulluar nga historia. Tentoja të rregulloja gabimet e komandantëve të së shkuarës. E ngrita dhe një herë revoltën e madhe hebreje kundër romakëve, e shpëtova Jeruzalemin nga shkatërrimi nga duart e ushtrisë së Titusit, i çova trupat e Bar Kokbas në muret e Roms, e mora Koloseun me sulm dhe ngrita flaurin hebre në majë të Kapitolit. Për këtë, e transferova Brigadën Hebreje të ushtrisë britanike në shek. I-rë para Krishtit dhe në ditët e Tempullit të Dytë dhe u gëzova me rrënimin që dy mitralozë u shkaktuan legjioneve madhështore të Adrianit dhe të Titusit të mallkuar. Një avion i vogël, një Piper i vetëm, e uli në gjunjë perandorinë kryelartë romake. Unë e shndërrova luftën e destinuar për të humbur të mbrojtësve të Masadës në një fitore bindëse të hebrenjve me ndihmën e një mortaje të vetme dhe disa granatave drejt. Dhe në fakt e njëjta dëshirë e çuditshme që kisha kur isha i vogël-dëshira për të dhënë një shans të dytë diçkaje që nuk mund t'a kishjte kurrë një të tillë-m është ende nja nga dëshirat që më shtyn akoma, sa herë që ulem të shkruaj një histori apo tregim". Mund të them se "shansi i dytë" është vërtetë vetëm letërsia.

Amos Oz e di shumë mirë se urrejtja ndaj popujve të tjerë është vetshkatërrimi i çdo populli që urren. E di se dashuria midis popujve është një strategji e fuqishme dhe reale. Ashtu si Martin Buberi edhe Amos Oz flet me artin e tij për miqësinë përfundimtare me palestinezët dhe arabët, por dhe me të tjerët. Për këtë qëndrim si kampion i humanizmit tërë ekstremistët sionistë e kanë parë vëngër dhe me ndihmë Amos Oz-in. Por letërsia e çoi Amos Oz-in në të gjitha kontinentet. I dha një shtrirje të paimagjinueshme në hapësirë. Por ajo që është në substancialja, i dha një shtrirje edhe në kohë.

Amos Oz e pasaportizon historinë dhe realitetin sipas optikës humaniste. Ai është sot më shumë se kurrë një qytetar i botës. Jo rastësisht ai tregon historinë e familjes së tij. Të gjithë janë njerëz të çuditshëm, plot

ëndra. Të gjithë janë njerëz që lexojnë libra në shumë gjuhë. Madje duken tuafë dhe të qendur rreth librave. Kanë paragjykimë, kanë të meta, bëjnë dhe marrëzira si të gjitha qënit njerëzore. Por e ndihmë përkatësinë e lidhjeve. Nuk i mohojnë as dashurinë, as vetruhimin dhe altruizmin.

Amos Oz është shprehur se "familja është institucioni më misterioz në botë, më paradoksal në botë, më i çuditshmi në botë dhe më interesante në botë. Nëqoftëse do më jepnin mundësinë të zgjidhja mes dy dëshirash, mundësia e parë që të jem në satelitin e parë që do të shkojë për në planetin e Marsit dhe mundësia e dytë që të kalojë një ditë vetme dhe një natë të vetme në shtëpinë e cilësdo familjeje, nuk ka rëndësi se e kujt familjeje, si një mizë në mur, unë do të zgjidhja të isha miza dhe jo astronaut". Kjo tingëllon madhështore, pikërisht se është hamuar çdo gjë e rëndomtë njerëzore por që është absolutisht në jetike.

Letërsia është antropologji e një niveli tjetër të lartë. Letërsia nuk është thjesht një shpikje mendore. Nuk është diçka e jashtme.

Letërsia është përherë e brendshme dhe infinitisht njerëzore.

Amos Oz është brenda njeriut që është kështjella e tij më e pamposhtur e artit. Amos Oz është Njeriu që kështu të jetë Shkrimtari.

Ai nuk shpik formula erudite të ekzistencës sepse mëton të jetë vetë ekzistenca. Ai nuk troket nëpër porta sepse e di që zarrat e njerëzve nuk kanë porta. Ai nuk mburret dhe as nuk mban poza të bujshme. Ai nuk i aktron fantazitë e tij, as nuk kërkon të na çudisë në aventura stilistike. Ai është i natyrshëm, pra është një ekologji letrare.

Bota e sotme globale konceptohet në mënyra nga më të ndryshmet dhe më absurdet. Politikanët, ekonomistët, strategët, filozofët, mediat etj krijojnë përfytyrime të mëme jashtë njeriut për të qenë një skllavëri, ose vetëskllavëri e njeriut modern dhe postmodern.

Funksioni i patjetërsueshëm i letërsisë është të bëjë të kundërtën; të rikthehet gjithmonë te njeriu. Kjo duket një herezi e përhershme dhe ndoshta një utopi. Por letërsia e Amos Oz-it na bind, na kthjellon, na fuqizon.

Faqet e fundit të romanit, ku Amos Oz përshkruan vdekjen e nënës së tij kanë një fuqi magnetike të papërbalueshme nga askush. Mund të jenë ndër faqet më të bukura që kam lexuar në jetën time. Një epitaf lirik i jashtëzakonshëm si i skalitur në bronz. Faleminderit Amos Oz!

---

# POEZI NGA

## MËHILL VELAJ

### Në fronin mbretëror të dashurisë

Si një endacak i mjerë,  
E c mes dy botëve:  
Në ndriçimin e syve tu,  
Dhe mahjeve të zemrës.  
I palodhur kërkoi dashuri, ëmbëlsinë,  
Ngrdhtësinë e një gjoksi,  
Që s'ë gjeta askund...  
Mbështet kokën në pasqyrën,  
E sekreteve të zemrës,  
Në argjendin e saj shfaqet,  
Fytyra jote e lukur;  
Dashuria ime!  
Në rërën e lagur buzë detit,  
Me pendën e një pulëbardhe,  
Hedh vargjet e dashurisë së zjarretë  
Të pastër e të kulluar.  
Unë një endacak i mjerë,  
I mplakur, i loçur...  
U lam në fronin  
Mbretëror,  
Me nënshkrimin:  
Dashuria ime.

### Kujtesë biblike

Qielli i vrënjtur nxinte pis si nata,  
kokat tona të raskapitura,  
gratë shamizeza që shtrëngonin kërkthijtë,  
rë gjinjte e tyre të shteruar,  
lotët ngrirë si kristalet e xhamit,  
binin në fytyrat e zbehta të foshnjave.

Në vend të qurështit u jepnin,  
pështymën e tharë

gjysmë helm e gjysmë sheqer,  
për frymë, për jetë,  
për ardhmëri!

Endeshim rrugë e pa rrugë,  
shkelnim mbi pallgje gjaku,  
kapërcenim gropat hapur në lëndina,  
mbushur me kufoma, këpuçë të gjakosura,  
mbuluar nga thëngjijtë e zinj,  
të djepave të djegur.

Zogjtë dimrakë na ngulnin sytë,  
kërkonin të zbulonin zemërimin,  
që vlonte në dëshpërimin e shpirttrave tanë.  
Cicërimat përkëdhelëse të tyre  
na shoqëronin në aratisjen drejt tokës arë,  
ngjallnin shpresën e shpresës,  
ëndrën e ëndrës,  
në egzodin biblik shqiptar.

Këputëm prangat që barbari serb,  
na kryqëzonte duart çdo ditë,  
nga frangjitet e kalave të lashta,  
lëshuan shigjetat dhe çanë,  
rrjetën e merimangës së zezë.

Shpërthyen fishekzjarët në erësisë,  
dhe universitet të Dardanisë,  
i dhanë dritën e shqiptarisë!

### Penel prej bari

Sa herë vjen pranvera, dal sodit  
Shpërthimin e luleve shumëgjyreshe,  
Që si hyjnesha legjendash  
Zukurojnë bahçen e shtëpisë time.  
Rrëmbej penelin të pikturoj frymëzimin,  
Të pikturoj sytë e vashës së lukur,  
Si sythet e parëve,  
Buzëqeshjen e saj, si pjalmi i luleve.  
Të pikturoj luleshqerrat kur çelin  
Aromën e tyre,  
Pranverën me të gjitha telajot.  
Të pikturoj dashurinë,  
Të vetmin yll që ndrin,  
Në mbretërinë e lunturisë së ndjenjave



# Letërsia dhe Globalizmi

Nga Prof.  
Sadik Bejko

Letërsia dhe globalizmi... në të parë, më ngjajnë si dy tema a fjalë që me përdhunë mund t'i vësh pranë e pranë. Në poezi pranëvënia e një fjalë me një tjetër disi jo të pranueshme për t'u vënë afër e afër, prodhon dimensionin artistik, befasinë asociative, shpërthimin e të moskuptueshmes, për ta kthyer edhe më qartë edhe më ndritshëm në kuptimësi. Borhesi mund të jetë nësuasi i madh i pranëvënies së fjalëve a temave që, në shikim të parë, asesi nuk mund të qëndrojnë bashkë. Rëhylli Aleq në një bodrum nëntoke. Sot një fantazi e tillë është e përshtesme, ylli Aleq në tunelin nëntokësor të një metroje diku në metropolet e mëdha të botës së sotme, janë kompiuterat. Kohët shikojnë dhe realiteti i teknologjisë së lartë ia kalon edhe një vizioni borhesian. Qytetërim i teknologjisë së lartë e ka globalizuar përfytyrimin dhe mënyrën tonë të jetesës... gjer në kufijtë e së pabesueshmes. Atëherë letërsia, ç'mund t'i japë letërsia një loto të tillë globale në tregje, në imazhe, në përfytyrime?

Letra, shkronja, të shkruarit është atribut i individit jo i qytetarit. Kulturën, letërsinë, pikturën e bën individit, qytetari, shoqëria bëjnë qytetërimin. Kur lexojmë një poezi nga Libri i Odave i Konfucit, një hajku japonez të Basios, një poezi të Safos, një sonet a tragjedi të Shekspirin në ndobëmi përpara individësh, jo para qytetarësh të qytetërimeve të ndryshme në veshje, në mënyrë jetese, në filozofi, qytetërim që edhe kanë vdekur, qytetërim që për kohën kur jetonin, mundet nuk kishin asnjë urë komunikimi mes tyre. Kjo vjen nga që qytetërimi dhe shoqëria i përgjigjen pyetjes: si të jetoj?, nërsa letërsia dhe kultura e lartë i përgjigjen pyetjes: përse jetoj? Mjafton të lexojmë disa nga veprat e autorëve që përmenda nësipër Librat e Tolstoit, apo Pavioni i kancerozëve të Solzenicinit, ku shtrihet hapur pyetja përse jetoj njeriu.

Koha e sotme e përjeton përditë realitetin e pyetjes: si të jetoj? Mijëra e miliona njerëz në botën e sotme po braktisin jetën tradicionale në vendet e tyre për të kërkuar një jetesë më të mirë në vendet e zhvilluara. Kjo ka ndodhur e ndodh edhe në Shqipëri. Gati një e treta e qytetarëve të vendit tim e kanë braktisur vendin, kulturën, mënyrën e të jetuarit, për të jetuar atje ku atyre dhe fëmijëve të tyre u prantohet një jetesë më e mirë. Kjo për mua, për vendin tim, mund të jetë shumë e trishtuar. Është koshatisur një e treta e një habitari kulturor, e një pastrie tradicionale, për një jetë më të mirë. Gjaku i një kulture, i një gjuhe, rrjedh e rrjedh

diku tjetër. Në këtë perspektivë mund të mendosh se gjuha e nënës sime, gjuha ime, gjuha shqipe, një nga gjuhët me themelore të familjes gjuhësore indoevropiane pas njëqind a dyqind vjetësh, mbase dhe më herët, mund të japë shpirt. Një ditë mund të shuhet e të asgjëschet. Nuk dua të bëj Kasandërën, por as t'i mbijll sytë përballë një realiteti kërcënues. Globalizmi triumfues i ka të gjitha të drejtat për ta asgjësuar një gjuhë dhe një kulturë kaq të vogël si kjo e imja. Gjuha ime që u ka mbijetuar sa e sa kohërave, i ka mbijetuar totalitaritetit të greqishtes dhe të latinishtes antike, i ka mbijetuar sundimit otoman kur gjuha shqipe me ligj u ndalua të shkruhet për pesë qind vjet, i mbijetoi totalitarizmit komunist, tashmë në erën e globalizmit mund të marrë rrokullimin vetvetiu në honet e asgjësimit. Thashë vetvetiu, vullnetshëm, se sot njeriu ka të drejtë të zgjedhë si të jetojë e ku të jetojë. Para disa javësh mediat dhanë lajmin e konfirmuar nga UNESCO, se në Indi vdiq folësjja e vetme e gjuhës Bo. Vdiq në Indi gjuha Bo se folësit e saj përvetësuan një gjuhë tjetër që u jepte më shumë mundësi jetese. Gjuhët vdesin në erën e sotme jo nga pushtimi ushtarak, por nga pushtimi i asaj si të jetoj, ku të jetoj, kush më jep më shumë bukë, në shumë të mira për të jetuar.

Mbase ky është ngushtësisht problemi im, i një vendi të vogël, i një gjuhe të vogël. Në erën e globalizmit e të universalizimit konkurrenca e ballafaqimi i vlerave do të jetë më i hapur, më i ashpër e mund të ndodhë që kultura të tilla si kjo e imja mund të tkurren e të tkurren dhimbshëm. Ky mbase është fati ynë në erën e globalizmit. Dhe ne duhet të kemi sy ta shohim, të përballlemi, jo t'i fshihemi këtij problemi.

Tani që më për hë u rreka ta kapërcej anën personale të problemit, mund të më lejohet të them ndonjë gjë për më tej.

Si rregull, kur dua të dimë ç'do të ndodhë nesër, ne shohim pas, për të parë ç'ka ndodhur në të kaluarën në situatat pak a shumë të ngjashme me tonën.

Gjithmonë kulturën, letërsinë e kanë prodhuar individët dhe qytetërimin – qytetarët, shoqëria. Letërsia e madhe dhe e qëndrueshme në vlerat e saj nuk ka folur për kohën, por për gjithëkohësinë e brendësive të individit. Duke folur për individin letërsia që në fillimet e saj ka gjetur një bar pabdëksie, një bar kundër totalitarizmit, ➡ 19

## Tregim

# PARAJSA KISHTE NGJYRE LEJLA...

Nga ELDA ÇOKU (KALLUPI)

Vajza ime e madhe, Nefeli lindi në një shtëpi të vogël, në mënjtë e një pallati të madh. Të vetmet gjëra që mund të shihje nga muret që ngriheshin rreth e qark si këstjellë, ishin gjethet e një fiku, të pallatit ngjitur, që kishin maninë sa herë që vinte vera të zgjatëshin kureshtare e të shilnin se ç'bëhej poshtë në dorrin tonë.., dhe një copë qiell..

Nefelit i pëlqente shpesh të mbledhte kokrrat e rena e të papjekura të fikut.

- Çfarë janë këto? - më pyeste e më lëshonte në prehër tre - katër fiq të tharë.

- Janë fiq, - i shpjegoja unë, por ajo kundërshtonte të kuptonte..

- Nuk janë fiq, janë kambana të vogla, si ato që mbajnë engjëjt nëpër libra, - më këshej ajo, e më shihte drejt në sy, me vështrim zhbines, duke pritur që ta miratoja.

Fjalët e saj më fusnin në mendime..Ndoshta vajza ime katër vjeçare kishte të drejtë. Ndoshta ishin kambana që binin nga ajo copë e vogël qielli...Ndoshta në mes të kaltërsisë engjëj të padukshëm na hidhnin kambana në formë fiqsh..Ndoshta... Nefeli priste për gjigje nga unë:

- Ë, mama? Kambana janë?

M'u desh atëherë t'i tregoja se parajsa në fund të fundit nuk është aq e madhe sa ç'e mendojnë njerëzit. Parajsa është ajo copë e çregullt gjeometrike qielli që lundron sipër dorrit të pallatit tonë, është ajo degë fiku që varet me kokë poshtë te muri i lartë, është çob kokërr fiku, që me fal çob kambanë, që të gjen poshtë e që me aq zell i mbledh..Kjo është parajsa bija ime.. thënimi i vogla lunturie ...

Nefelica ime qeshte. Dhe e qeshura e saj i rrezonte të gjithë ata mure të larta që na rrethonin e që shpesh na kishin bërë të ndjeheshim si të burgosur.

- Ah, shpirti im ku jetojmë. Mes çimentos dhe betonit..i gëzohemi një dage të bletë që është vetë parajsa në mes këtij ferri gri..

Erika, vajza ime e vogël, lindi në një shtëpi të madhe, në këmbë të një pallati të vogël, të rrethuar nga drita, nga qielli e nga perët.. Përballë dritares së shtrihet një park i vogël që minte i gjelbëruar dimër verë..Unë nuk i njoh mirë emrat e të gjitha

perëve të tij, por shoh aty kuribulla, tunxhe, pisha, bredha..dhe mbi të gjitha një lofatë. Perë më të bukur nuk kam parë në jetën time. Nuk ju gënjej nëse ju rrefej që e achuroj, e bashkë me mua edhe vajzat e mia.

Në shtëpinë e re hymë në shkurt. Përveç pishave edhe bredhave gjithë perët e tjera ishin zhveshur e dukej sikur i ftohti i kish hyrë deri në palcë..Marsi, ara, erdhi me shpejt se asnjëherë tjetër. Shtëpia kishte nevojë për sistemimin e plaçkave. Erika brenda në folenë e ngrohtë të barkut tim, mezi priste të dilte. Nefeli kërkonte nëpër ballkon një degë të vogël fiku, që t'i dhuronte kambanat që lanë prapa.. Të gjithë kishim nga një detyrë për të kryer.

Marsi erdhi.. shtëpia u sistemua, morëm vesh që brenda barkut kisha prapë vajze..Nërsa Nefeli gjeti sërish një perë fiku, m'u poshtë ballkonit tonë.. Kësaj radhe kambanat vetëm i shihte, nuk mund t'i mbledhte më..Perët filluan ditë për ditë të shtojnë nga një gjethe në shumë në trupin e tyre të mardhur nga i ftohti i dimrit..

Një ditë marsi u befusua me një perë të vogël përballë dritares së. Nuk na kishte rënë në sy deri atë mëngjes, e mërkdhë ishte aq e bukur sa të linte pa fryrë. Ishte sikur natën për gjithë natën një piktor i palodhur kishte vizatuar lule të panumërta në ngjyrë lejla, duke e mbushur kurorën e saj me një notë magjie..Nuk mund të gjej fjalë e të përshkruaj se çfarë kontrasti bënin në mes të gjelbërimit të pafund të perëve të tjera, ato lule të vogla. Të dukej sikur në gjithë atë park vetëm lofata ekzistonte. Erika lindi e u rrit duke parë këtë perë, nërsa Nefeli i la mënjanë kambanat e ju përkushtua luleve lejla..Kudo që ikim kërkojmë të gjejmë parajsa të reja....

- Janë kaq të bukura sa duken sikur bien nga parajsa, - më tha ajo një ditë tek rrimin të tria në kurorën lejla, mërkdhë që një shi lulesh lejla binte sipër nesh. Ishte me të vërtetë një çast i magjishëm..Toka poshtë këmbëve tona u mbush me to..Ngrita kokën dhe pamja që pashë më ka ngulur thellë në kujtesë. M'u duk sikur hapja sytë pas një gjumi të rëndë dhe e vetmja gjë që shihja në qiell ishte kurora e lofatës. Qielli ishte bërë i vogël, gati nuk dukej mes degëve dhe luleve lejla..Ishte bërë njësh me ngjyrën e tyre, ishte shkruar brenda tyre..Dhe e gjithë kjo bukuri më qetësonte aq sa nuk desha asgjë tjetër të jetoja në ato çaste.., përveç asaj qetësie të pafund ...

- Nëse parajsa ka me të vërtetë një ngjyrë, - thashë me vete, me sytë të ngulur te lulet e lofatës..duhet patjetër të këtë ngjyrë lejla..

Athinë, 13 prill 2010.



Nga Eleonora Gjoka

### ATJE KU LINDA UNË

Atje ku kam lindur unë  
Seç luan vala me zhumë;  
Atje ku jam rritur unë,  
S'ka fillim, nuk ka as fund.

Kur nëna më perkundi mua,  
Ninulla s'duheshin kënduar,  
Se këndonte gjithë vendi,  
Që nga vala, gjer te shkëmbi.

Qielli blu shkrihet me detin,  
Deti përçafon bregdetin,  
Dhe bregdeti dalëngadalë,  
Shtrihet me fushën e rrallë.

Të gjithë janë të dashuruar,  
Bregut i mbahen shtrënguar,  
Malet mbajnë kryet përpjetë,  
Gati sikur mëshen me retë.

Në gjoks mbajnë Qeparonë,  
Thonë: "E kemi pjellën tonë".  
Kështu e mbrojnë mot-motit,  
Kështjellë si ballkon të Zotit!

Tinguj valesh, këngë malli,  
Erë borzilok kundërmon bari,  
Mushur ullinj e portokalle,  
Zëri i bylbylit, si tinguj kitare..

Këndo, shpirt, këngën e shkuar,  
Gjithë këta vjet jemi përmalluar,  
Si të bëjnë, t'i dëgjojnë prapë,  
Ninullat e ëmbra, në çdo prag!

# "Pa pranga"

Poezi nga Eljona Lupe

## Guxo

Nëse ke guximin,  
më vri sonte!  
Godit krenarinë time  
në erër të përlësisë

Në shpirt: Qëllo!Qëllo!  
Nga dhanja veç të psherëtiçjë.  
Mos mëshiro mëkatin satanik,  
në erër të dritës qiellore.

Nëse s'gjen armë vrastare  
drejtoju gjuhës të t'i falë.  
Armë të forta veç ajo ka  
në erër të përsosmërisë  
gramatikore.

## Sytë

Varre që mbajnë gjallë kuforat  
e tyre,  
kufoma fantazmagorisht  
hipnotizuese.  
Oqean ku nbytet shpirti i  
dashuruar  
Llavë vullkanike  
botëasgjësuese.

## Mëkat

Më fal ti bardhësi  
që të zhvirgjëroj sa herë  
kur penën marr dhe derdh mbi

ty  
bojë mëkatore.

Mund të më dënosh  
me forcën e një virgjëreshe.  
Po.. përse duhet vallë  
shanjtëria  
në jetën tokësore?

\* \* \*

Unë s'isha Judë Iskarioti  
që Krishtin për tridhjet  
monedha

traditë.

Ti ishe Pont Pilati  
që dhanobjen në zemrën time

kryezi.

## Gjej...

..Ngushëllim,  
në gjoksin e hapësirës.  
Page,  
në kaltërsinë e qiellit.  
Zjarr shpirtëror,  
në dashurinë e yjeve  
flakëronjës,  
Bukuri,  
në harmoninë e natyrës,  
Frymëzim,  
në mjaltin e pashtershëm të  
poetëve,  
Dhanobje,  
në ëmbëlsinë gënjeshtare  
tokësore.

# TË FALMINDERIT, FAIK BRUÇI!

Nga Faik Xhani

Unë dhe ti i përkasim historisë së re moderne. Në rrugëtimin historik të genit e të zhvillimit të pemës gjeneologjike, stanjonohemi e atakojmë pika dëligimi për vendlindjet tona, si dy motra shekullore që kanë respektuar, rindrojtur, plotësuar e zhukuruar njëra-tjetrën.

Lukani i Dibrës, oazi mes malesh rrethuar, me ujë të pastër, të freskët e të shijshëm, me ajër shëndetli e me vlagën e tokës të rindrojtur me të gjitha endëzimet e lulëshurtave, në shkuj ka nxjerrë lura, që u ka qesh sofra dhe u ka kënduar pushka.

Pikërisht, në këtë begati natyrore ka ecur e jetuar, në rrugëtimin historik edhe fisi Bruçi, i Lukanit të Dibrës. Ai, jo vetëm me kullat, si monumente kulture i'a ka shtuar bukuritë Lukanit, por edhe me lumerangun njerëzor i ka dhënë zë e erër asaj.


Rapidi yt konkurues e dinjitoz, ka hehur dritë, bukuri e hijeshi në mozaikun e komplekseve ndërtimore, aq të pëlqyera edhe në kryeqytetin shqiptar, Tiranë. Jo vetëm kaq, por edhe pena jote, Faik Bruçi, me librin "Fisi Bruçi i Lukanit të Dibrës", hodhi themele të sigurta e la vlera të vjera, që nuk do të humbasin kurrë!

Ai libër është një monument i gjallë i vendlindjes tënde, nga ku

brezat kanë ç' të marrin e ç' të mësojnë.

Më këtë libër Faik Bruçi, i ngrite trevës së Kater -Grykëve, por edhe fisit Bruçi, një përmendore rrezatuese e frymëzuese, si burimi i atyre bjeshkëve.

Materiali fotografik i



përzgjedhur e cilësor me koloritin e ngjyrave, si qëndisimat e artizanës së talentuar në "trupin" e këtij libri, sjellin në syrin e gjithsecilit lexues, Lukanin me bukurinë, machështinë, historinë, individë të veçantë, trima, punëtorë e të dëgjuar dhe shumë resurse natyrore që ldojnë në së miri për zhvillimin e turizmit malor, në këtë krahinë me peisazhe të mrekullueshme, natyrë mahitëse dhe me burjari e histori të lashtë e të mallë. Pikërisht, ky pasqyrim i përzgjedhur, nuk ka si të mos tërheqë, jo vetëm lexuesin, por edhe turistët shqiptar,

europianë, e pse jo, edhe botërorë.

Duke ecur në rrjedhat historike të Fisit Bruçi, gjithkush, por veçanërisht unë, frymëzohem, gëzohem, krenohem dhe nderhem, se ai ka qenë dhe është i lidhur me vendlindjen time, Lisin e Matit, fisin dhe familjen Xhani si dhe shumë miq të saj, si Ramadan e Sulejman Ndrejçoni, Shaban Dervishi, Kros Shehu, Hysen Lala, po edhe me më të rinjtë, si Hysen Dervishi, një hulumtues i spikatur i folklorit dibran, Mevlud Buci, një intelektual me vlera e një gunë e pashtershme krijuese etj.

Edhe vet, ju z, Faik, keni befasuar gjithkënd dhe keni fituar status të veçantë në heshtje, emër e zë me kompleksin e ndërtimeve me fantazi, hijeshi, hapsirë e kompozim arkitektonik konkurues e të lakmuar nga qytetarët e vendit tonë. Por edhe në fushën e krijintarisë, me librin "Fisi Bruçi i Lukanit të Dibrës" ju, i keni dhënë një shembull gjithë biznesit shqiptar dhe jeni flaurngritur. Ju, keni ditur t'i menaxhoni të ardhurat tuaja, jo vetëm në fushën e ndërtimit, por edhe në hapsirën mjedisore e krijuese, duke i dhënë gjithë komunitetit të biznesit një mesazh shumëkuptimplotë: "Mos e harroni vendlindjen dhe çilni sa më shumë dritare në "ngrehinën" e librit!"

Ja sepse ju falenderoj, ju mbështes dhe ju nderoj, z.Faik Bruçi!



Brenda pak javësh, Stephen Kosslyn, një psikolog në Harvard, do të zhvillojë një bisedë për imazhin mendor dhe kujtesën, se cilat prej tyre aktivizohen kur jemi duke lexuar. Zunshine ka thënë se më 1999 ajo bashkë me 10 të tjerë kanë fituar aprovimin nga Shoqata Moderne e Gjuhëve për të krijuar një grup diskutimesh mbi avitjet konjitive të letërsisë. Vitin që shkoi, numri i këtyre anëtarëve shkoi 1200. Ndryshe nga Gottschall, Zunshine sheh avitje konjitive kur krijon teori të tjera letrare. Zunshine është i interesuar veçanërisht në atë që shkenëtarët e quajnë teoria e mendjes, që përfshin aftësinë e një njeriu për të interpretuar një gjendje mendore të dikujt tjetër dhe për të lokalizuar burimin e një pjese të veçantë të informacionit me qëllim që të vlerësojë bazueshmërinë. Romanet e Jane Austen shpesh janë të ndërtuara prej interpretimeve të gabuara. Tek "Emma" heroina pranon si të vërteta sinjalet e Eltonit lidhur me të qenit romantik të shokut me emrin Harriet, edhe pse ai ka ndërmend të martohet me Erinë. Ajo keqinterpreton sjelljen e Frank Churchill dhe z. Knightly dhe shpang objektet reale të dashurisë së tyre. Njerëzit mund të përjetojnë 3 procese mendore në të njëjtën kohë, thotë Zunshine. P.sh. propozimi "Peter tha që Pauli besonte që Meri i pëlqente çokollatat" nuk është shumë i vështirë për t'u ndjekur. Po të shtosh një nivel tjetër, duket e pamundur. Autorët modernë si Virginia Woolf shpesh sfidojnë njëri-tjetrin, për shkak se ajo kërkon që lexuesin ta mbajë

## Përse lexojmë prozë letrare?

gjallë me 6 procese mendore të ndryshme apo ajo që studiuesit e quajnë nivel i qëllimit. Mbase, aftësia njerëzore me këto 3 nivele që përmendëm më lart është e lidhur ngushtë me intrigat e marrëdhënies seksuale, sugjeron Zunshine. A mendon se ai është i tërhequr ndaj saj? Zunshine argumenton që njerëzit gjejnë bashkëveprimin e 3 proceseve mendore. "Nëse do të kem ndonjë axhendë ideologjike", thotë ajo "do pëpiqesha të krijoja një rrëfim që do të përfshinte një trekëndor të mendjeve, sepse kjo është diçka që na duket shumë mbresëlënëse". Zunshine është pjesë e një grupi studimor të sajuar prej studiuesve të shkollave dhe psikologëve konjitivë, të cilët janë duke përdorur foto të çastit për të eksploruar mekanizmat e të lexuarit. "Ne vazhdojmë të pranojmë që ka një ndryshim midis llojit të leximit që njerëzit bëjnë kur lexojnë Prustin apo Henri James, apo qoftë edhe një gazetë. Kjo është një vlerë që i shtohet procesit kur jemi duke lexuar tekste letrare", nënvizon Michael Holquist, profesor në Yale, i cili është edhe kreu i këtij projekti. Grupit iu desh pothuaj një vit për të gjetur se si mund të testohet kompleksiteti. Ata u morën me leximin mendor ose me fjalë të tjera, sa i aftë është një individ të diktojë burime të shumëfishta. Studimi pilot do të përfshijë 12 subjekte. "Çdo gjë do vendoset mbi një magnet dhe do të jepen një set me tekste për kompleksitetin e përshkallëzuar që varet nga vështirësia e burimit

që monitorohet dhe ne do të shohim me kujdes se çfarë ndodh në tru", shpjegon Holquist. Një tjetër profesor i gjuhës angleze në Stanford, po ekzaminon teorinë e mendjes prej një perspektive të një natyre tjetër. Ajo nis nga supozimi që evolucioni ka një dorë në dashurinë për prozën letrare dhe më pas vazhdon të ekzaminojë teknikën rrëfimore të njohur si "stili i lirë indirekt", që përzien zërin e personazheve me rrëfimitarin. Stili indirekt i aftëson lexuesit për të përjetuar 2 ose 3 procese mendore në të njëjtën kohë. Ky stil, që është vula e nisjes së një romani që në shekullin 19 me Jane Austen, është zhvilluar sepse ajo kënaq "interesin tonë të madh ndaj mendimeve sekrete të të tjerëve", thotë Vermeule. Rruga midis 2 kulturave - shkencës dhe letërsisë - mund të ecë në të dy kahet. "Proza letrare siguron një perspektivë të re në atë që ndodh në evolucion", thotë William Flesch, një profesoreshë e gjuhës angleze në universitetin e Brandeis. Leximi i prozës letrare ndihmon që të shpjegojmë se si altruizmi zhvillohet pavarësisht geneve tona egoiste. Heronjtë e prozës letrare janë quajtur "nëshkuesit altruistë". Ata nuk kanë se ç'fitojnë. Ne kënaqemi me prozën letrare sepse është e mbushur me nëshkues altruistë: Odisea, Don Kishoti, Hamleti, Herkuli Poirot etj. "Nuk është se zhvillimi na sjell një depërtim në të thellë tek proza letrare", vazhdon Flesch, "por na sjell një depërtim në zhvillimin e saj të mëtejshëm"

## Stefano Benni

Lindi në Bolonja më 12 gusht 1947. Gazetar, shkrimtar dhe poet Italian i njohur nga fansat e vet si "Ujku", mboshta një nga shkrimtarët italianë më të mirë që jetojnë, por sigurisht më argëtuesi. Është autor i shumë romaneve dhe antologjive me tregime të suksesshme si Bar Sport, Elianto, Toka, Margarita Dolcevit, Komikët luftëtarë të trenbur, Bari nën det etj. Romani i tij Komikët luftëtarë të trenbur u bë film me titull Muzikë për kafshë të moshuara. Romanet e tij pëmbajnë, përmes ndërtimit të botëve dhe situatave imagjinare, një satirë të fortë të shoqërisë italiane të dhjetëvjeçarëve të fundit. Stili i tij i shkrimit përdor gjerësisht lojra fjalësh, neologjizma dhe parodi të stileve të tjera letrare.

### Tregim

# Diktatori dhe vizitori i bardhe

Si lum ata që kanë uri dhe etje për drejtësi, sepse do të ekzekutohen

P. Belkio

Na ishte një herë një diktator që kishte burgosur, torturuar dhe vrazë burra dhe gra të vendit të vet. Një ditë e lajtrërojnë për vizitën e Kryetarit të Njerëzve të Mirë.

Meqë ky kryetar ishte shumë i fuqishëm, udhëtonte nëpër botë dhe kub që shkonte njerëzit ngarendin që ta shilnin, diktatorit iu desh të përgatitej që ta priste sa më mirë.

Vrau të gjithë të torturuarit që të mos thuej se ekzistonte tortura, të gjitha nënat e desaparecidos-ve që të mos thoshin që fëmijët ishin të tillë, të gjithë të burgosurit që të mos thuej që burgjet ishin plot dhe e mbyshi qytetin me banderuola mirëseardhjeje.

Por një natë para vizitës nuk vuri sy në gjurë : e dinte se Kryetari i Njerëzve të Mirë e njihte të mirën dhe të keqen dhe kishte ardhur për ta qortuar : do t'i thoshte gjëra të trenshme para të gjithëve duke ia nxjerrë të palarat në shesh për krimet e kryera.

Kështu në nëngjes në aeroport ishte shumë i nervozuar. Në vend të uniformës së zakonshme me

dragoj dhe thika, kishte veshur një kostum gri me kravatë dhe në vend të truprojeve të zakonshëm kishte një skortë me murgesha. Qdo murgeshë mbante në krah një fëmijë, të cilët Kryetari i Njerëzve të Mirë, i deshte shumë.

Vizitori zbriti i gjithi i veshur me të bardha nga një avion i bardhë, puthi tokën dhe fëmijët, përshëndeti diktatorin dhe bashkë përshkruan mugët e qytetit mes duartrokitejeve të njerëzve, pasi edhe ai që nuk duartrokiste mihej me shkop.

Kur mbodheshin në hyrjen e diktatorit Kryetari i Njerëzve të Mirë nbylli derën me çelës dhe tha :

Tani unë dhe ti le të shkëmbijnë disa mendime.

Diktatori u droch. Kishte ardhur për të çasti i së vërtetës. Ishte gati të binte në gjunj dhe të kërkonte falje, kur Vizitori i bardhë tha:

- Më pëlqen ky vend, është i qetë.

- Po, jo keq - tha diktatori.

- Shihet që njerëzit jetojnë mirë..

- Mjaft..sikur të ankohet ndonjë, por..

- Edhe në vendin tim - tha Kryetari i Njerëzve të Mirë - ka ndonjë që gjithmonë ankohet.

- Pastaj, me thënë të drejtën, ndonjëherë..më është dashur...

Dashur çfarë?

- M'u desh.. të ndërhyja.

- Ju kuptoj.

Nga këto fjalë diktatori ra në gjunjë. Sa i mirë ishte kryetari i Njerëzve të Mirë! Sa mësim të madh që po i jepte! Jo me anatama dhe ofendime, por me forcën e përcëllimës dhe faljes.

Duke i treguar edhe mugën..

Oh, po! Edhe ai do të jetë i mirë dhe mirkuptues si Kryetari i Njerëzve të Mirë! I puthi dorën, unazën, mëngën dhe tha:

- Nik do të arrestoj më njeri, do të shpall zgjedhje të lira, do të rraloj torturën, do të rral skadkat e vdekjes..e kuptova nësimin e tij.

Kryetari i Njerëzve të Mirë e tërhoqi menjëherë dorën.

- Ju jeni i qendrur - tha - mjerë ju nëse e ndërmeni këtë veprim!

Diktatori u drojt.

Kur Vizitori i Bardhë u nis, diktatori rifilloi të burgoste dhe torturonte dhe vriste, por nuk i jepte të njëjtën shije.

Është e vërtetë - mendonte - ka takime që ta ndryshojnë jetën.

Përkthau Arjan Th. Kallço

perandorive, despotizmit, kundër strukturave në dukje të qëndrueshme e të frikshme. Në Kinën e dinastitë Tan, në Kinën e epokës së poetëve Li Bo dhe Du Fu, artistët zgjodhën filozofinë e individualizmit taoist përkundrejt konfucianizmit etatist. Zgjodhën subjektivizmin, të intën, të veçantën, përballë me Murin e Madh të shtetit, të së përgjithshmes.

Totalitarizmin e globalizmin për kohën e shpiku dhe Roma e Oktavian Augustit. Krishterimi që lindi diku në periferitë e papërfillshme të kësaj perandorie të gjithëfuqishme, fillimisht përqindhej dhe ndjekësve të tij u rezervohet kryqëzimi, një dënim i denjë për shkelletit. Globalizmin rrok e sfidoi periferia, rrethina dhe krishterimi triumfoi mbi gëmadhat e globalizmit rrok.

Për të mos e zgjatur, Dostojevski, një i dënuar me vdekje nga Cári, prodhoi një letërsi të një universaliteti të pakufi, të pacak për sot dhe për nesër. F. Kafka një nëpunës i papërfillshëm, një individ i ndrydhur në kasafortat e ndryshkura të burokracisë, prodhoi një letërsi shpërthyes që hidhte në erë që nga përvuajtja reale e jetësore atë që në dukje ishte e sigurt, e betuar.

Unë vij nga një vend që i përkiste globalizmit komunist. Një globalizëm ky aq i sigurt, sa ata që i kundërviheshin, i asgjësonte në kampe, i pushkatonte, i varte në litar. Globalizmi komunist ishte mizorisht i dhunshëm në devizën e tij: o me mua, o me asgjësimin tënd. Dhe prapë, përtej këtyre alternativave përjashtuese, ajo që mbeti nga gjithë gëmadhat e globalizmi politik, ekonomik, kulturor komunist që fjala, letërsia, ajo letërsi që nuk e pranoi shtatin e Prokustit ku donte ta vinte letërsinë komunist. Letërsia nuk është përjashtuese në fjalën, në lëndën, në natyrën e saj. Si në gjithë kohërat, nga letërsia shqipe e kohës së komunizmit mbeti ajo letërsi që nuk iu kushtua totalitarizmit të ngjirë e çrjerëzor komunist, por letërsia që u strehua te brendësia e gjithëkëndshme e individit.

Disa këtë magji të letërsisë për të qenë e gjithëkohshme, për të triumfuar ndaj qytetërimeve asfikësuese dhe strukturave të ngjira shtetërore, e lidhin me fjalën. Fjala në letërsi është një tërësi e pakontrolluar nga vetja, nga ai që e shkruan, nga ai që e lexon sot a që do ta lexojë nesër, po dhe pas një mijë vjetësh. Kjo aftësi e fjalës për të përmbajtur kodë që bëhen të zbërthyeshme në mënyrë të re në kohë të reja e në kontekste të tjera, sjell atë që Bahasi thoshte se kush

lexon sot Don Kishotin ai po e rikrijon nga e para romanin që Servantesi e ka shkruar rreth pesëqind vjet më parë. Në saje të fjalës edhe letërsia që të ngjan se është shkruar për një kohë të caktuar, në perën e shkrintarëve mjeshtërorë i kapërcen kohërat.

Në një farë mënyre, me ç' thashë deri tani, tentova të provoj se letërsia ka një histori të gjatë mbijetese, ajo ka ditur t'u mbijetojë totalitarizmeve e globalizmeve që nuk janë shpikur sot. Ajo u ka mbijetuar si totalitarizmeve perandorakë edhe atyre ideologjikë.

Prapë në fillim të kësaj fjale unë paraqita frikën nga totalitarizmi globalist lidhur me gjuhën time dhe me kulturën time të vogël.

Gjuha shqipe dokumentohet për herë të parë aty nga fillimi i shekullit të pesëmbëdhjetë në tërësinë e një tekst latinisht të një peshkopi katolik. Dhe fjalët e para të shkruara shqip, për sa dija njeh deri më sot, janë fjalët e formulës së pagëzimit: unë të pagëzohem për emrit të atit, birit dhe të shpirtit të shenjtë. Peshkopi shqiptar, duke parë se Shqipëria po pushtohet nga otomanët, se priftërinjtë po vriteshin dhe zona të tëra nuk po mbuloheshin me priftërinj, i porosiste besimtarët që fëmijët mund t' pagëzonin vetë prindërit duke thënë formulën e mësipërme.

Libri i parë në gjuhën shqipe është një libër kishtar, i shkruar nga një prift katolik me emrin Gjon Buzuku më 1555, pothuaj njëkohshëm me përkthimin e Biblës në gjuhën gjermane nga Martin Luteri.

Siç e thashë, gjuha shqipe u mbijetoi kohëve, edhe pushtimit otoman, nga i cili trarbej aq shumë peshkopi që shkroi formulën e pagëzimit, pushtim që e ndaloi me ligj shkrimin e gjuhës shqipe. I mbijetoi dhe totalitarizmit komunist. Sot gjuha shqipe ka një shkrintar të kalibrit botëror, Ismail Kadare, që është i ftuar nderi në mbledhjen ndërkombëtare të PEN-it këtu në Bled, i ftuar dhe për promovimin e një libri të përkthyer në gjuhën shqipe.

Prapë dua t'i kthehem idesë sime, se të rrezikuara nga globalizmi mund të jenë pikërisht gjuhët e vogla dhe kulturat e vogla, të cilat kanë një histori të vështirë mbijetese. Zhdokja e kulturave të tilla nga presioni i globalizmit është real. Për të mos rënë një dukuri e tillë, unë do të doja të përsëris fjalët e peshkopit që e shkroi i pari gjuhën time: gjuhë shqipe, unë të pagëzohem për emrit të atit, të birit e të shpirtit të shenjtë. Por rritase nuk duhen vetëm lutjet.



# KALENDARI AFRIKA E JUGUT 2010



NGA BOTIMET"ADA" NË  
BASHKPUNIM DHE ME  
MBËSHTETJEN E EHW

**Në treg**  
**KALENDARI**  
**AFRIKA E JUGUT**  
**2010**

**TË GJITHA**  
**SKUADRAT**  
**HISTORIKU &**  
**KURIOZITETE TË**  
**ANDRYSHME**  
**I GJITHË**  
**KALENDARI**  
**ME NGJYRA**  
**DHE**  
**VETËM 50 LEKË**

# B O T I M E T A D A

**OBELISK** Çmimi  
50  
lekë

**NË KËTË NUMËR** **Libra të rinj**  
**të Shtëpisë Botuese "ADA"**

SHARL BODLER

ARJAN KALLÇO

ALKETA DERVISHAJ

ENVER DEMISHAJ

AGRON KOSTA

KOLEC TRADOINI

KONSTANDIN DHAMO

FASLI HALITI

**Rrebelimi i**  
**një vajze të briahtë**  
**Nga Istref Haxhillari**

**DOKTOR KAPROLLI**  
**Libër i ri me fabula i**  
**Kozma Gjinit**  
**Nga Bardhyl Xhama**



**Zbuloni librat**  
**dhe autorët më të**  
**shitur 2009...**

**92 OBELISK** Çmimi  
50  
lekë

Revistë e përpunimit letrar-artistik Vite 1-46 / botuar Nr. 91 / Prill 2010 ORGAN I SHTËPISË BOTESE "ADA"

**Leximi i mimikës**

Nga Faik Xhani

**DOSIER**

**Nobelisti që e ndihmoi fati**

Tregim

**Sarah**

Nga Xhevatir Cirongu

**Magjia e plakut me bastun**

Nga Xhevatir Cirongu

**"Madonnina mia"**

Nga Suzana Kuqi

**POEZI**

Nga

**Maram Al Masri**

Përkthyer nga Horald Kulli

Poezi nga Desard Kaja

Poetët e rinj

në faqet e "OBELISK"



**TREGIM**  
**Konia**  
**e bardhë**  
Nga Pali Shtëmbari

**EKSKLUZIVE**

**Poezi nga**  
**Teresinka Pereira**

Problemat e shpirtit të Mëkëmbësve dhe Artistëve Botërorë



**POEZI**  
**Në natën time**  
**je hënë**



Nga Theodoruq Giza

**93 OBELISK** Çmimi  
50  
lekë

Revistë e përpunimit letrar-artistik Vite 1-46 / botuar Nr. 93 / Prill 2010 ORGAN I SHTËPISË BOTESE "ADA"

**INTERVISTA**

**"Punoni sikur do jetoni**  
**njëmijë vjet ....."**

**INTERVISTË ME**  
**SHKËMBIMIN**  
**VULLNET MATO**



**EKSKLUZIVE**

**LETËR NËNËS**

**NGA ESENINI TEK**  
**SULKUQI**

Nga Gëzim Llojdia



**POEZI**  
**NGA**  
Patricia Garza Soberanis

**HUMOR**



**ÇFARË KANË**  
**KAFSHËT PËR**  
**NJERZIT?**  
Nga Pilo Zyba

**Tregim i përkthyer**  
**BLESHEH**  
Nga Kimi Truchotsky  
**SAN SALVADOR**  
Peter Bished

**Tregim**  
**DHIMBJE E VONUAR**  
Nga Istref Haxhillari  
**LARGIM NGA YLLËSIA**  
Nga Miltiadh Davidhi

**Kur historia kthehet në këngë**  
Nga Faik Xhani

**POETI I MENDJES SË NDRITUR**  
**DHE GJAKUT TË NDEZUR**  
Nga Jakup Ceraja

**Një libër që pasqyron fantazinë femnore**  
Nga Agim Bajrami  
Xhevatir Cirongu  
**POEZI NGA** Sofia Dako  
Qirjako Stefani

**NJOFTIM**

**OBELISK**  
**SE SHPEJTI**  
**ORGANIZON**  
**KONKURSION**  
**E POEZISE**